

Transparenca dhe Pjesëmarrja në Veprimtaritë Legjislative INTEGRIMI NË BE

Buletin informativ Nr. 10

mars 2007

Deklarata e Berlinit

Për shekuj me radhë Europa ka qenë një ide, me shpresën për paqe dhe mirëkuptim. Kjo shpresë është realizuar. Unifikimi Europian ka bërë të mundur paqen dhe prosperitetin. Kjo ka sjellë një sens komuniteti dhe ka tejkaluar ndryshimet. Çdo Shtet Anëtar ka kontribuar në bashkimin e Europës dhe në forcimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor. Falë thirrjes për liri të popujve të Europës Lindore Qendrore ndarja e panatyrshme e Europës i përket së shkruarës. Bashkimi Europian tregon se ne kemi mësuar nga mësimet e dhimbshme të një historie të manifestuar nga një konflikt i gjakosur. Sot ne jetojmë së bashku ashtu siç asnjëherë nuk qe e mundur.

Ne, qytetarët e Bashkimit Europian, jemi bashkuar për më të mirën.

I. Në Bashkimin Europian, ne po i kthejmë idealet tona të përbashkëta në realitet: për ne, individi është thelbësor. Dinjiteti i tij është i pacënueshëm. Të drejtat e tij janë absolute. Burri dhe gruaja gëzojnë të drejta të barabarta. Ne po përpiqemi për paqe dhe liri, për demokraci dhe shtet ligjor, për respekt reciprok dhe përgjegjësi të përbash-

Berlin Declaration

For centuries Europe has been an idea, holding out hope of peace and understanding. That hope has been fulfilled. European unification has made peace and prosperity possible. It has brought about a sense of community and overcome differences. Each Member State has helped to unite Europe and to strengthen democracy and the rule of law. Thanks to the yearning for freedom of the peoples of Central and Eastern Europe the unnatural division of Europe is now consigned to the past. European unification shows that we have learnt the painful lessons of a history marked by bloody conflict. Today we live together as was never possible before.

We, the citizens of the European Union, have united for the better.

I. In the European Union, we are turning our common ideals into reality: for us, the individual is paramount. His dignity is inviolable. His rights are inalienable. Men and women enjoy equal rights. We are striving for peace and freedom, for democracy and the rule of law, for mutual respect and shared responsibility, for prosperity and secu-

(vijon në faqen 2)

Në këtë numër:

1. Deklarata e Berlinit (shqip/anglisht). *faqe 1-2*
2. Deklarata e Berlinit dhe e Ardhmja e Bashkimit Europian. *Ditmir Bushati faqe 3*
3. Nga Veprimtaria e Komisionit Parlamentar të Integrimit. *mars 2007 faqe 1, 4*
4. Nga Veprimtaria e Kuvendit në lidhje me Integrimin *mars 2007 faqe 5-6*
5. Nga Monitorimi i Komisioneve të Përhershme Parlamentare *26 shkurt-19 mars 2007 faqe 6-8*
6. Projektligji "Për Turizmin". *faqe 9-19*
7. Kalendar i Punimeve të Kuvendit 10 - 30 prill 2007 *faqe 20-22*

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN MARS 2007

Komisioni i Integrimit, për muajin mars, në lidhje me fushën e kompetencës së tij, ka shqyrtuar projektligjet e mëposhtme, të propozuara nga Këshilli i Ministrave sipas neneve të parashikuara nga Kushtetuta (neni 121).

Në bazë të Rregullores së Kuvendit neni 32 pika 1 neni 33 pika 1 dhe 2, neni 34 pika 1 dhe 2 dhe neni 36, mbledhjet në kalendarin tre javor të miratuar në seancë plenare, Komisioni për Integrimin Europian në mbledhjet e tij ka miratuar programin e punës së tij dhe ka shqyrtuar projektligjet e mëposhtme nisma të Këshillit të Ministrave.

Për shqyrtimin e këtyre projektligjeve, me propozim të drejtuesit të mbledhjes, janë ftuar specialistë nga ministratë përgjegjëse për projektligjet, përkatësisht nga Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit si dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

· *Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi, (OPRC), 1990"*

(vijon në faqen 4)

Deklarata e Berlinit

(vijon nga faqja 1)

këta, për prosperitet e siguri, për tolerancë dhe pjesëmarrje për drejtësi dhe solidaritet.

Në kemi një mënyrë unike të jetuari dhe punuari së bashku në Bashkimin Europian. Kjo shprehet nëpërmjet ndërvëprimit demokratik të Shteteve Anëtare dhe institucioneve Europiane. Bashkimi Europian është themeluar mbi të drejta të barabarta dhe bashkëpunim mbështetës reciprok. Kjo na bën të mundur të mendojmë një balancë të drejtë ndërmjet interesave të Shteteve Anëtare.

Ne ruajmë në Bashkimin Europian identitetet dhe traditat e ndryshme të Shteteve të saj Anëtare. Ne jemi zhvilluar nëpërmjet kufijve të hapur dhe një varietetet dinamik kulturash, gjuhësh dhe rajonesh. Ka shumë synime të cilat nuk mund t'i arrijmë vetë, por vetëm së bashku. Detyrat janë ndarë ndërmjet Bashkimit Europian, Shteteve Anëtare dhe vendeve të tyre dhe autoriteteve vendore.

2. Ne po përballemi me sfida të mëdha të cilat nuk ndalen në kufijtë kombëtarë. Bashkimi Europian është përgjigja jonë ndaj këtyre sfidave. Vetëm së bashku ne mund të vazhdojmë të ruajmë idealin tonë të shoqërisë Europiane në të ardhmen për të mirën e të gjithë qytetarëve të Bashkimit Europian. Ky model Europian ndërthuret me suksesin ekonomik dhe përgjegjësinë sociale. Tregu i përbashkët dhe *euro* na bën të fortë. Prandaj ne mund të ndikojmë në tregjet ndërkombëtare në përputhje me vlerat tona. Mirëqënia e Europës qëndron në njohuritë dhe aftësitë e njerzve të saj; ky është çelësi për rritjen, punësimin dhe kohesionin social.

Ne do të luftojmë së bashku terrorizmin dhe krimin e organizuar. Ne jemi për liritë dhe të drejtat civile gjithashtu në përpjekje ndaj atyre që janë në kundërshtim me to. Racizmit dhe ksenofobisë nuk duhet t'i jepet kurorë më liri.

Ne angazhohemi për zgjidhje paqësore të konflikteve në botë për të siguruar që populli të mos bëhet viktimë e luftërave, terrorizmit dhe dhunës. Bashkimi Europian kërkon të promovojë lirinë dhe zhvillimin në Europë. Ne duam të ndalojmë varfërinë, urinë dhe sëmundjet. Ne duam të vazhdojmë të kemi një rol drejtues në këtë luftë. Ne synojmë të drejtojmë së bashku rrugën për politikën energjitike dhe mbrojtjen e ambientit dhe të japim kontributin tonë në parandalimin e rrezikut global të ndryshimit të klimës.

3. Bashkimi Europian do të vazhdojë të ketë sukses në hapjen dhe vullnetin e Shteteve të saj Anëtare për të konsoliduar zhvillimin e brendshëm të BE-së. Bashkimi Europian do të vazhdojë të promovojë demokracinë, stabilitetin dhe prosperitetin përtej kufijve të saj.

Me unifikimin e Europës ëndrra e një gjenerate të hershme u bë realitet. Historia jonë na kujton që duhet ta mbrojmë këtë për të mirën e brezave të ardhshme. Për këtë arsye duhet që gjithmonë të rinovojmë formën politike të Europës në një hap me kohën. Prandaj sot, 50 vjet pas firmosjes së Marrëveshjeve të Romës, ne jemi të bashkuar në qëllimin tonë për ta vendosur Bashkimin Europian mbi baza të përbashkëta të rinovuara përpara zgjedhjeve të Parlamentit Europian në vitin 2009.

Nga sa dimë, Europa është e ardhmja jonë e përbashkët.

ity, for tolerance and participation, for justice and solidarity.

We have a unique way of living and working together in the European Union. This is expressed through the democratic interaction of the Member States and the European institutions. The European Union is founded on equal rights and mutually supportive co-operation. This enables us to strike a fair balance between Member States' interests.

We preserve in the European Union the identities and diverse traditions of its Member States. We are enriched by open borders and a lively variety of languages, cultures and regions. There are many goals which we cannot achieve on our own, but only in concert. Tasks are shared between the European Union, the Member States and their regions and local authorities.

II. We are facing major challenges which do not stop at national borders. The European Union is our response to these challenges. Only together can we continue to preserve our ideal of European society in future for the good of all European Union citizens, This European model combines economic success and social responsibility. The common market and the euro make us strong. We can thus shape the increasing interdependence of the global economy and ever-growing competition on international markets according to our values. Europe's wealth lies in the knowledge and ability of its people; that is the key to growth, employment and social cohesion.

We will fight terrorism and organised crime together. We stand up for liberties and civil rights also in the struggle against those who oppose them. Racism and xenophobia must never again be given any rein.

We are committed to the peaceful resolution of conflicts in the world and to ensuring that people do not become victims of war, Terrorism and violence. The European Union wants to promote freedom and development in the world. We want to drive back poverty, hunger and disease. We want to continue to take a leading role in that fight.

We intend jointly to lead the way in energy policy and climate protection and make our contribution to averting the global threat of climate change.

III. The European Union will continue to thrive both on openness and on the will of its Member States to consolidate the Union's internal development. The European Union will continue to promote democracy, stability and prosperity beyond its borders.

With European unification a dream of earlier generations has become a reality. Our history reminds us that we must protect this for the good of future generations. For that reason we must always renew the political shape of Europe in keeping with the times. That is why today, 50 years after the signing of the Treaties of Rome, we are united in our aim of placing the European Union on a renewed common basis before the European Parliament elections in 2009.

For we know, Europe is our common future.

Deklarata e Berlinit dhe e ardhmja e Bashkimit European

Më 25 Mars 2007, Bashkimi European festoi 50-vjetorin e Traktatit të Romës, dokumentin themelor mbi bazën e të cili qëndron e gjithë ngrehina ligjore dhe institucionale e BE-së, në një moment të vecantë, kur mbi organizatën e përbërë nga 27 shtete qëndrojnë pikëpyetje të mëdha rreth së ardhmes së saj, sidomos pas dështimit të referendumeve për Kushtetutën Europiane në Francë dhe Hollandë.

Sikundër ishte paralajmëruar qysh se Gjermania mori timonin e drejtimit të BE-së këtë fillim viti, festimet do të kulmonin me hartimin e të ashtuquajturës “Deklarata e Berlinit” nga kryetarët e shteteve anëtare të BE-së dhe drejtuesit kryesorë të institucioneve komunitare, si për të dëshmuar edhe një herë se “Bashkimi European është përgjigja më e mirë ndaj sfidave”¹.

Në të vërtetë, festimet për 50-vjetorin e BE-së kësaj radhe u shoqëruan më një test të trefishtë:

- duhej gjetur një balancë midis sukseseve dhe dështimeve për gjatë 50 vjetëve,
- duhej vlerësuar në mënyrë të ndershme c’farë shkon dhe c’farë nuk po shkon brenda radhëve të Bashkimit,
- si dhe duhej vështruar përpara në kërkim të një kuptimi sa më të drejtë për sfidat me të cilat pritet të përballen BE në gjysëm e dytë të shekullit, sfida të cilat natyrisht do të jenë shumë të ndryshme nga ato ekzistueset. Shumica e studjuesëve bien dakord se forca e suksesit të BE-së gjatë këtyre viteve qëndron pikërisht tek procesi i zgjerimit, i cili ka ndihmuar në përhapjen e demokracisë, stabilitetit, sigurisë dhe prosperitetit për gjatë kontinentit. Në fakt, zgjerimi ka shërbyer si për shtetet që janë antarësuar rishtazi (21), por edhe për shtetet themeluese (6) duke zgjeruar tregjet dhe duke inkurajuar zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin.

Megjithatë, krahas suksesit, procesi i zgjerimit ka nxjerrë në pah edhe disa probleme:

Së pari, kultura politike e një pjesë të shteteve të antarësuar rishtazi vazhdon të mbetet e dobët duke shfaqur simptomat e të kaluarës totalitare.

Së dyti, gjeografia e Bashkimit European është shume diverse duke mbledhur së bashku shtete të cilat nuk kanë pasur lidhje historike dhe bashkëpunimi me njera-tjetrën.

Qytetarët në zona të ndryshme gjeografike të BE-së kanë përjetime të ndryshme gjithashtu. Kështu, kur Ukrahina u përfshi nga valët e “revolucionit të portokallinjte”, qytetarët polakë si dhe ato në shtetet baltike u ndjenë më të përfshirë se kurrë më parë. Ndërkohë, spanjollët kanë interesa më të drejtpërdrejta në Afrikën Veriore e rrjedhimisht janë më të ndjeshëm ndaj asaj cka ndodh në atë pjesë të globit që është më pranë interesave të tyre. Sondazhe dhe studime të ndryshme gjithashtu dëshmojnë se qytetarët në pjesën perëndimore të BE-së identifikojnë shumë pak lidhje me Bullgarinë dhe Ru-

maninë, dëshmi kjo edhe e skepticizmit me të cilin u përjetua antarësimi i këtyre dy shteteve në BE.

Sikurse dihet, BE-ja është ndërtuar mbi parimet e qarkullimit të lirë të mallrave, shërbimeve, punës dhe kapitalit, të barazisë para legjislacionit european të të gjithë qytetarëve, të barazisë sovrane të shteteve, dhe të transferimit të konsiderueshëm financiar të burimeve nga rajonet e pasura në ato të varfra. Për këto arsye është e rëndësishme që vlerat e përbashkëta të jenë sa më të qëndrueshme për qytetarët e shteteve anëtare të BE-së në mënyrë që politikat kryesore të BE-së të gëzojnë konsensus të gjerë dhe vetë organizata të mos humbasë besimin tek qytetarët europianë.

Shumica e vlerave europiane janë të njëjta me ato perëndimore në përgjithësi, por në fakt ato dallojnë së paku në tre drejtime:

- Vlerat europiane janë të orientuar më tepër ndaj politikave sociale. Është kjo arsyeja që Deklarata e Berlinit përfshin solidaritetin si parim europian.
- Vlerat europiane janë të orientuara më tej ndaj politikave laike dhe liberale kur bëhet fjalë për dënimin me vdekje, kontrollin mbi armët apo abortin.
- Vlerat europiane synojnë të promovojnë një system global qeverisje të bazuar mbi institucione solide ndërkomëtare.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, Deklarata e Berlinit vë theksin tek fakti që 50 vjet pas nënshkrimit të Traktatit të Romës, krerët e shteteve anëtare të BE-së qëndrojnë të bashkuar për t’i dhënë një dimension të ri Bashkimit, cka do të mund të shërbejë si bazë për zgjedhjet e ardhshme të Parlamentit European për në vitin 2009, pas dështimit të referendumeve për Kushtetutën Europiane dhe skepticizmit gjithnjë e në rritje në lidhje me të ardhmen e Strategjisë së Lisbonës, synimi i së cilës është që ta kthejë Bashkimin Europen në ekonominë më konkurruese në botë brenda vitit 2010.

Por, për të arritur këtë, BE-ja ka nevojë për një udhëheqje të vendosur e dinamike për të ecur në rrugën e Monnesë, Shumanit dhe Spaak me qëllim përfundimin e procesit ambicioz të bashkimit të kontinentit. 50 vjet pas krijimit të saj BE-ja ka se me çfare të krenohet dhe duhet të vazhdojë në rrugën e konsolidimit dhe përhapjes së vlerave dhe parimeve të saj në të gjithë kontinentin.

Shënime

¹ Shih, pjesën e dytë të Deklaratës së Berlinit.

Ditmir Bushati

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN MARS 2007

(vijon nga faqja 1)

Shqipëria ushtron një veprimtari në transportin detar nga anijet e huaj të vendeve të ndryshme, nga anijet e peshkimit dhe ato turistike, të cilat mund të përmbledhen në shifrat e mëposhtme

Transporti ndërkombëtar numëron rreth 70 anije me tonazh rreth 60000 GRT dhe 200 anije peshkimi. E gjithë kjo veprimtari paraqet një rrezik për ambjentin detar duke shtuar ndotjen. Në të njëjtën kohë, portet detare të Shqipërisë numërojnë një transport deri në 2000 mjete lundrimi ku përfshihen edhe ato mjete që transportojnë karburant

Qëllimi i konventës është të sigurojë që të gjitha shtetet të kenë marrë masat për të kundërvepruar ndaj ndaj incidenteve të ndotjes në det nga derdhjet e karburantëve. Shqipëria është palë e një sërë konventave që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit detar, në bazë të një strategjie të përcaktuar nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO). Konventa për mjedisin detar detyron operatorët e fushave që kanë të bëjnë me veprimtari që mund të shkaktojnë ndotje në det, të paraqesin planin e tyre të kontingjencës për kufizimet e ndotjes si dhe për rekuperimin e gjëndjes normale në det.

Nga kjo konventë shteti shqiptar do të marrë asistencë nga shtetet e mëdha për ngritjen e strukturave dhe të standarteve të nevojshme për ruajtjen e ambjentit detar nga ndotja prej produkteve të naftës.

Gjithashtu konventa do të fuqizojë bashkëpunimin midis vendeve detare nëpërmjet memorandumeve.

· *Projektligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, Për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregëtisë së Lirë të Europës Qëndrore".*

Me datë 19 dhjetor 2006 në Bukuresht u nënshkrua marrëveshja për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregëtisë së lirë të Europës Qëndrore CEFTA 2006. Marrëveshja është nënshkruar edhe nga Bosnje Hercegovina, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi, Republika e Kroacisë, Republika e Moldavisë, Republika e Serbisë, Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, si dhe nga dy vendet anëtare të reja të BE-së, Republika e Bullgarisë dhe Republika e Rumanisë. Kjo marrëveshje zëvendëson 31 marrëveshjet e tregëtisë së lirë ndërmjet vendeve të Europës Juglindore. Marrëveshja e vetme e tregëtisë së lirë është bashkërenduar në vijimësi me komunitetin e biznesit Shqiptar nëpërmjet këshillimeve, mendimeve në takime të ndryshme para zhvillimit të raundve të negociatave.

Shqipëria ka zhvilluar negociatën dy palëshe me tre nga vendet negociuese siç janë Kosova, Kroacia dhe Mali i Zi. Në këtë marrëveshje paraqiten liberalizimi i plotë i importeve dhe eksporteve të produkteve industriale nga data 1 janar e vitit 2007. Kjo datë përkon me periudhën e përfundimit të periudhës tranzitore të përcaktuar në marrëveshjet dy palëshe të tregëtisë së lirë me vendet që kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Lidhur me produktet bujqësore, procesi paraqitet në dy forma:

1. Transferimi i të gjitha konçesioneve për Serbinë, Maqedoninë dhe Bosnjë Herecegovinën.
2. Rinegociimi i konçesioneve në fushën e produkteve bujqësore për vendet e tjera do të bëhet me Kroacinë, Kosovën dhe Malin e Zi.

Për mirëfunksionimin e marrëveshjes së vetme të tregëtisë së lirë CEFTA të zgjeruar dhe të amenduar, palët kanë rënë dakort për ngritjen dhe funksionimin e një sekretariati të përhershëm me qendër në Bruksel, i cili do të mbështet financiarisht nga donatorët si sekretariati i CEFTA-s dhe donatorë të tjerë për një periudhë fillestare tre vjeçare.

Marrëveshja nuk ka efekte të reja financiare për buxhetin e shtetit.

Sipas nenit 4 të marrëveshjes ajo do të hyjë në fuqi më 1 maj 2007.

· *Projektligji "për aderimin e republikës së shqipërisë në konventën ndërkombëtare "për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre".*

Numri i lëvizjes së personave përtej kufijve të shteteve ku ato janë qytetarë të atij vendi është rritur shumë vitet e fundit konsideruar ndryshimet që ka pësuar arena ndërkombëtare pas rënies së murit të Berlinit dhe ndryshimit të sistemeve totalitare në vende të ndryshme të botës.

Ky numër sipas të dhënave të institucioneve që merren me politikën migratore shkon rreth 150 milion migrantë duke përfshirë edhe punëtorët migrantë, refugjatët, azilkërkuesit si dhe tipologji të tjera migrimi. Në shkallë botërore, ky numër përbën 2% të popullsisë botërore. Për këtë arsye, për të siguruar respektimin e të gjitha të drejtave që lidhen me këtë kategori personash, konventa synon plotësimin e standarteve ndërkombëtare, përmes të cilëve sigurohet trajtimi, përkujdesja dhe të drejtat e migrantëve, përfshirë këtu edhe migrantët e dokumentuar dhe të padokumentuar.

Në këtë kuadër, konventa trajton detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë shtetet dërguese dhe ato pritëse për trajtimin e punëtorëve migrantë dhe të të gjithë anëtarëve të familjeve të tyre.

Në tërësi, konventa synon të luajë një rol parandalues dhe eliminimin e shfrytëzimit të të gjithë punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre gjatë procesit migrator. Aderimi në këtë konventë do të përmirësojë legjislativon vendas për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Gjithashtu aderimi në konventë është në kuadrin e zbatimit të MSA-së, të zbatimit të planit kombëtar për procesin e integritit evropian, në zbatim të strategjisë kombëtare të migracionit dhe të planit kombëtar të veprimit të migracionit.

NGA VEPRIMTARIA E KUVENDIT TË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME INTEGRIMIN PËR MUAJIN MARS 2007

Kuvendi i Shqipërisë, për muajin mars 2007, në lidhje me fushën e Integrimit europian, ka miratuar projektligjet e mëposhtme, të propozuara nga Këshilli i Ministrave sipas neneve të parashikuara nga Kushtetuta (neni 121).

· *Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre".*

Në tërësi, konventa synon të luajë një rol parandalues dhe eliminimin e shfrytëzimit të të gjithë punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre gjatë procesit migrator. Aderimi në këtë konventë do të përmirësojë legjislacionin vendas për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Gjithashtu aderimi në konventë është në kuadrin e zbatimit të MSA-së, të zbatimit të planit kombëtar për procesin e integrimit europian, në zbatim të strategjisë kombëtare të migracionit dhe të planit kombëtar të veprimit të migracionit.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;

Komisioni i Jashtëm;

Komisioni i Integrimit Europian; Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

· *Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes strategjike, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor Europian".*

Kjo marrëveshje është nisur nga qëllimi i mirë dhe nga interesi i ndërsjellë për të rritur bashkëpunimin në luftën kundër formave të rënda të krimit ndërkombëtar, si dhe në kuadër të angazhimeve në përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në procesin e Stabilizim – Asocimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Marrëveshja bazohet në platformën dhe në vullnetin e përbashkët të palëve për të luftuar format e rënda të krimit të organizuar që kanë të bëjnë me: trafikimin e paligjshëm të drogës, krimet e lidhura me lëndët bërthamore dhe radioaktive, kontrabandën e paligjshme të imigrantëve, trafikimin e qënieve njerzore, krimin me mjete motorike, falsifikimin e parasë dhe mjeteve të pagesës si dhe veprimtari të paligjshme të pastrimit të parave.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;

Komisioni i Jashtëm;

Komisioni për Sigurinë Kombëtare;

· *Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Europës Qëndrore".*

Në këtë marrëveshje paraqiten liberalizimi i plotë i importeve dhe eksporteve të produkteve industriale nga data 1 janar e vitit 2007. Kjo datë përkon me periudhën e përfundimit të periudhës tranzitore të përcaktuar në marrëveshjet dy palëshe të tregëtisë së lirë më vendet që kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Lidhur me produktet bujqësore, procesi paraqitet në dy forma:

1. Transferimi i të gjitha konçesioneve për Serbinë, Maqedoninë dhe Bosnjë Herecegovinën

2. Rinegociimi i konçesioneve në fushën e produkteve bujqësore për vendet e tjera do të bëhet me Kroacinë, Kosovën dhe Malin e Zi.

Për mirëfunksionimin e marrëveshjes së vetme të tregëtisë së lirë CEFTA të zgjeruar dhe të amenduar palët kanë rënë dakort për ngritjen dhe funksionimin e një sekretariati të përhershëm më qendër në Bruksel, i cili do të mbështetet financiarisht nga donatorët si sekretariati i CEFTA-s dhe donatorë të tjerë për një periudhë fillestare tre vjeçare.

Marrëveshja nuk ka efekte të reja financiare për buxhetin e shtetit.

Sipas nenit 4 të marrëveshjes ajo do të hyjë në fuqi në 1 maj 2007.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;

Komisioni i Jashtëm;

Komisioni për Integrim Europian;

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

· *Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi, (OPRC) 1990".*

Shqipëria ushtron një veprimtari në transportin detar nga anijet e huaj të vendeve të ndryshme, nga anijet e peshkimit dhe ato turistike, të cilat mund të përmblihen në shifrat e mëposhtme

Transporti ndërkombëtar numëron rreth 70 anije me tonazh rreth 60000 GRT dhe 200 anije peshkimi. E gjithë kjo veprimtari paraqet një rrezik për ambientin detar duke shtuar ndotjen. Në të njëjtën kohë, portet detare të Shqipërisë numërojnë një transport deri në 2000 mjete lundrimi ku përfshihen edhe ato mjete që transportojnë karburant

(vijon në faqen 6)

NGA VEPRIMTARIA E KUVENDIT TË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME INTEGRIMIN PËR MUAJIN MARS 2007

(vijon nga faqja 5)

Qëllimi i konventës është të sigurojë që të gjitha shtetet të kenë marrë masat për të kundërvepruar ndaj incidenteve të ndotjes në det nga derdhjet e karburantëve.

Shqipëria është palë e një sërë konventave që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit detar, në bazë të një strategjie të përcaktuar nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO).

Konventa për mjedisin detar detyron operatorët e fushave që kanë të bëjnë me veprimtari që mund të shkaktojnë ndotje në det, të paraqesin planin e tyre të kontingjencës për kufizimet e ndotjes si dhe për rekuperimin e gjëndjes normale në det.

Nga kjo konventë shteti shqiptar do të marrë asistencë nga shtetet e mëdha për ngritjen e strukturave dhe të standarteve të nevojshme për ruajtjen e ambjentit detar nga ndotja prej produkteve të naftës.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Komisioni i Jashtëm; Komisioni për Integrim Europian; Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

· *Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin, me kredi, të projektit "Ndërtimi i terminalit të trageteve dhe shesheve përreth, në Portin e Durrësit".*

Qëllimi kryesor i kredisë, që jep Banka Europiane e Investimeve (BEI) është ndërtimi i ndërtesës së terminalit të trageteve të pasagjereve në portin kryesor të Shqipërisë në Detin Adriatik, si dhe punime të tjera ndihmëse në funksionin e tij.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijnë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Komisioni i Jashtëm

MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PARLAMENTARE PËR PERIUDHËN 26 shkurt - 19 mars 2007

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

1. Gjatë periudhës 26 shkurt – 19 mars 2007 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar gjithsej 7 mbledhje. Në kalendar kanë qenë të parashikuara 9 mbledhje. Në 7 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 400 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 57 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme si dhe raporteve të institucioneve të pavarura, në mbledhjet e komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse si dhe përfaqësues të institucioneve të pavarura.

3. Gjatë kësaj periudhe është konstatuar se deputetët kanë qenë më të informuar vetëm për projektligje të veçanta si p.sh. Projektligji "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike". Edhe gjatë këtyre tre javëve është konstatuar se deputetët nuk janë të informuar paraprakisht për projektligjet me objekt ratifikim marrëveshjesh ndërkombëtare dhe nuk kërkojnë informacion për detyrimet që rrjedhin nga ky dokument. Në 7 mbledhje të realizuara numërohen rreth 48 diskutime të zhvilluara nga deputetët. Mesatarisht në secilën mbledhje zhvillohen 7 diskutime kryesisht nga të njëjtët deputetë. Deputetët kanë qenë më aktiv sidomos në mbledhjet që kanë patur për objekt raportimin e institucioneve të pavarura siç janë Avokati i Popullit, Prokurori i Përgjithshëm si dhe Komisioni i Shërbimit Civil. Gjithashtu gjatë shqyrtimit të projektligjeve të veçanta janë propozuar 5 amendamente.

4. Edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve. Gjithashtu deputetët vazhdojnë të vijnë me vonesë në mbledhje dhe si rrjedhojë edhe mbledhjet fillojnë me vonesë. Mesatarisht mungojnë 5 deputetë për mbledhje nga 19 që ka komisioni. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore me grupe interesi apo subjekte të tjera joqeveritare. Gjatë këtyre tre javëve komisioni ka ushtruar edhe veprimtari kontrolluese ndaj institucioneve të pavarura. Për këtë qëllim komisioni ka përgatitur raporte.

5. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media.

Disa vlerësime: Siç rezulton nga monitorimi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka një pjesëmarrje të rregullt të deputeteve në mbledhjet e komisionit. Deputetët vijnë me vonesë dhe largohen përpara mbylljes së mbledhjes.

(vijon në faqen 7)

MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PARLAMENTARE për periudhën 26 shkurt - 19 mars 2007

(vijon nga faqja 6)

Gjatë këtyre tre javëve në ndryshim me periudhat e mëparshme nuk ka pasur raste të firmosjes së prezencës nga deputetët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhje. Përsa i përket pjesëmarrjes në diskutime dhe informimit paraprak të deputetëve për projektligjet, edhe gjatë kësaj periudhe është konstatuar se deputetët informohen paraprakisht vetëm për projektligje të veçanta. Gjatë këtyre 3 javëve janë zhvilluar 7 mbledhje nga 9 të parashikuara në kalendar. Gjatë kësaj periudhe në mbledhjet e komisionit kanë marrë pjesë vetëm ekspertë të qeverisë dhe përfaqësues të institucioneve të pavarura por jo përfaqësues të grupeve të interesit.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

1. Gjatë periudhës 27 shkurt – 19 mars 2007 Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje. Të gjitha mbledhjet e zhvilluara kanë qenë të parashikuara në kalendar. Mbledhjet e zhvilluara gjatë këtyre tre javëve kanë pasur për objekt diskutimi projektligje të ndryshme si dhe në mbledhjen e datës 12.03.07 Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka miruar strukturat organike të disa institucioneve dhe enteve rregullatore. Kohëzgjatja mesatare e mbledhjeve të monitoruara është 55 minuta. Gjatë këtyre tre javëve janë zhvilluar gjithsej 330 minuta punë efektive në komision.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm përfaqësues të qeverisë. Nuk është shfrytëzuar ndonjë ekspertizë ose burim tjetër, gjatë mbledhjeve të zhvilluara. Në mbledhjet e zhvilluara ka pasur debate dhe diskutime kryesisht nga deputetët më aktiv. Në 6 mbledhje të realizuara numërohen rreth 20 diskutime nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 3 amendamente në 5 mbledhje të monitoruara.

3. Gjatë punimeve të këtij kalendari janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve në mbledhje. Mungojnë mesatarisht 5 deputetë për mbledhje nga 17 që ka komisioni. Mbledhjet fillojnë zakonisht me vonesë dhe kjo shkaktohet për shkak të mungesave të deputetëve.

4. Në mbledhjen e datës 6.03.007 komisioni ka patur për objekt diskutimi projektligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Ky projektligj ishte diskutuar dhe miratur një ditë më parë në parim. Gjatë shqyrtimit nën për nën të këtij projektligji pati shumë debate dhe diskutime dhe në fund komisioni vendosi që të marë edhe mendimin e komisionit të ligjeve dhe më pas ta shqyrtojë përsëri. Në kalendar ishte parashikuar që ky projektligj të kalonte në seancë më datë 8.03.07,

duke mosrespektuar afatin 3 ditor të parashikuar nga rregullorja.

5. Nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore dhe veprimtari tjetër kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

6. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media.

Disa vlerësime: Gjatë punimeve të këtij kalendari krahasuar me punimet e komisionit në periudha të tjera kohëzgjatja e mbledhjeve të komisionit vlerësohet të jetë e përafërt me mesataren e periudhave të tjera. Megjithatë debatet, diskutimet si dhe amendamentet janë bërë përsëri nga të njëjtët deputetë, ndërsa pjesa tjetër e deputetëve vazhdojnë të qëndrojnë pasiv ose mjaftohen vetëm me pyetje informuese. Edhe gjatë kësaj periudhe debatet kanë qenë shumë të ashpra. Është konstatuar se përsëri deputetët mbështeten vetëm në burimin e informacionit të qeverisë. Edhe gjatë kësaj periudhe në mbledhjet e komisionit nuk kanë marrë pjesë grupet e interesit.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

1. Gjatë periudhës 27 shkurt – 19 mars 2007 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar gjithsej 4 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar por nuk janë të caktuara paraprakisht datat e zhvillimit të tyre. Kohëzgjatja mesatare e mbledhjeve të zhvilluara ka qenë 48 minuta. Gjithsej janë zhvilluar 170 minuta punë efektive në komision.

2. Gjatë kësaj periudhe nuk janë shqyrtuar projektligje. Në këto 4 mbledhje është miratur projektkalendari; është miratur plani i veprimt të KE-së për ligjin për median elektronike. Gjithashtu janë zhvilluar 2 seanca dëgjimore, 1 me Ministrin e Arsimit dhe 1 seancë tjetër me kryetarin e Kryetarin e Këshillit Drejtues të RTSH-së.

3. Gjatë këtyre tre javëve nuk janë bërë amendamente. Janë bërë rreth 5 diskutime nga deputetët kryesisht në seancën dëgjimore të zhvilluar me Ministrin e Arsimit me objekt diskutimi maturën shtetërore dhe koeficientet e pranimi në shkollat e larta..

4. Edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve. Gjithashtu ka raste kur deputetët vijnë me vonesë pasi ka filluar mbledhje ose në përfundim të saj. Ardhja e deputetëve me vonesë nuk i pengon asnjëherë ata të firmosin prezencën në mbledhje.

(vijon në faqen 8)

MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PARLAMENTARE për periudhën 26 shkurt - 19 mars 2007

(vijon nga faqja 7)

Disa vlerësime: Në 4 mbledhjet e zhvilluara dy prej tyre kanë qenë të organizuara në formën e seancave dëgjimore por jo me përfaqësues të grupeve të interesit. Edhe gjatë kësaj periudhe krahasuar edhe me komisionet e tjera të monitoruara janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve në mbledhje.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

1. Gjatë periudhës 27 shkurt – 19 mars 2007 Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar gjithsej 7 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Objekti i mbledhjeve ka qenë i parashikuar dhe nuk është ndryshuar. Në 7 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 280 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 40 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme, të propozuar nga Këshilli i Ministrave, në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Në raste të veçanta në komision kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të enteve shtetërore. Në asnjë rast nuk kanë qenë të pranishëm përfaqësues të grupeve të interesit. Gjatë punimeve të këtij kalendari është konstatuar se vetëm një numër i vogël deputetësh kanë informacion paraprak për projektligjet e diskutuara dhe po këto deputetë marrin pjesë në debate dhe diskutime ndërsa pjesa tjetër e deputetëve janë pasiv ose mjaftohen me ndonjë pyetje drejtuar specialistëve të qeverisë.

3. Në 7 mbledhje të zhvilluara numërohen 30 diskutime të zhvilluara nga deputetët. Diskutimet knaë të bëjnë kryesisht me deklarime të deputetëve, pyetje dhe opinione reth projektligjeve të diskutuara. Gjithashtu janë propozuar 4 amendamente të cilat kanë qenë të natyrës teknike. Vlen të përmendet se gjatë veprimtarisë së këtij komisioni janë miratuar projektligje edhe me konsensus të të gjithë deputetëve siç është rasti i miratimit të projektligjit “Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë”.

4. Edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve në mbledhje. Deputetët vazhdojnë të vijnë me vonesë dhe të largohen pa mbaruar mbledhja. Mesatarisht kanë qenë të pranishëm 9 deputetë nga 16 që ka komisioni. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media. Nuk ka patur pengesa për të marrë pjesë në mbledhje.

5. Gjatë punimeve të këtij kalendari është zhvilluar një seancë dëgjimore me objekt raportimin e ERT-së për punën e vitit 2006. Diskutimet e deputetëve në këtë se-

ancë janë zhvilluar në formë pyetjesh dhe komentesh mbi punën e ERT-së.

Disa vlerësime: Edhe gjatë kësaj periudhe në këtë komision janë konstatuar mungesa të deputetëve që në disa raste krijojnë vështirësi në plotësimin e kuorumit. Krahasuar me tre javët e kaluara konstatohet një pjesëmarrje më e vogël e deputetëve në diskutime dhe debate. Po kështu ka rënë edhe numri i deputetëve që marrin pjesë në këto diskutime. Deputetët kanë qenë më pak të informuar se në periudhat e tjera të mëparshme. Gjithashtu edhe kohëzgjatja e mbledhjeve të komisioneve ka qenë relativisht e vogël krahasuar me voluminin e punës që ka ky komision.

Gjatë kësaj periudhe është konstatuar se në veprimtarinë e tij ky komision arrin të gjej edhe mirëkuptimin dhe konsensusin e të gjithë deputetëve siç është rasti i miratimit të projektligjit “Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë”.

Disa vlerësime të përgjithshme për komisionet e monitoruara:

Gjatë punimeve të komisioneve parlamentare për periudhën 26 shkurt – 19 mars 2007 ka pasur shumë diskutime dhe debate, por kryesisht nga një numër i kufizuar deputetësh të cilët janë më aktiv. Gjatë kësaj periudhe në të gjitha komisionet e monitoruara është konstatuar një pjesëmarrje më e vogël e deputetëve në diskutime. Gjithashtu shumica e deputetëve nuk kanë qenë të informuar paraprakisht për projektligjet që janë shqyrtuar në komisione. Edhe gjatë kësaj periudhe nuk rezultoi që deputetët të kenë informacion paraprak për projektligjet me objekt ratifikim marrëveshjesh ndërkomëtare. Ky fakt konstatohet në mënyrën e kalimit të tyre pa pyetje dhe pa zhvilluar asnjë debat. Gjatë kësaj periudhe në mbledhje kanë qenë gjithmonë të pranishëm edhe opozita dhe nuk janë konstatuar raste të bojkotimit të mbledhjeve.

Edhe gjatë këtyre tre javëve, ashtu si edhe në periudhat e tjera, të pranishëm në mbledhjet e komisionit kanë qenë kryesisht vetëm përfaqësuesit e qeverisë. Edhe pse gjatë këtyre tri javëve janë zhvilluar disa seanca dëgjimore të pranishëm në mbledhje kanë qenë vetëm përfaqësues të subjektve me të cilët zhvillohej kjo seancë dhe në asnjë rast nuk ka patur përfaqësues të grupit të interesit. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Një interes të veçantë gjatë këtyre tre javëve ka treguar edhe media.

Gjatë monitorimit të punimeve të këtij kalendari janë konstatuar përsëri mungesa të shumta të deputetëve si dhe raste kur deputetët vijnë me vonesë dhe largohen pa përfunduar mbledhja.

Projektligji “Për Turizmin”

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR TURIZMIN”

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve paraqet projektligjin e ri “Për turizmin”, i cili ofron, në mënyrë cilësore dhe në përputhje të plotë me standardet e direktivat e Bashkimit Europian, rregullimin e sektorit dhe mbulimin e një sërë aspekteve, të patrajuara nga ligji në fuqi.

Përgatitja e këtij projekti synon të ndihmojë konkretisht zhvillimin e industrisë turistike, në përputhje me drejtimet strategjike të zhvillimit të turizmit, duke u dhënë përparësi burimeve të trashëgimisë, kulturore dhe natyrore.

Nisma për hartimin e një ligji të plotë për fushën e turizmit është në përputhje me programin e qeverisë, 2005-2009, i cili i referohet rishikimit të kuadrit ligjor për turizmin, si një përparësi në veprimet afatshkurtra.

Ligji në fuqi, miratuar në vitin 1993, ka pësuar ndryshime të kufizuara gjatë viteve, të cilat lidhen kryesisht me ndryshimin e emërimit të institucionit përgjegjës në këtë fushë, si dhe me kufizimin e periudhës së përfitimit të stimujve. Në këtë mënyrë, ligji në fuqi nuk është një ligj gjithëpërfshirës, por një ligj specifik, me synim identifikimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe dhënien e lejeve brenda këtyre zonave. Fakti që në këto zona ka patur kualitet të ulët të njësive akomoduese, të paafta për të hyrë në tregun turistik ndërkombëtar, si dhe zhvillime ilegale, peizazhe, ndërtime dhe natyrore, të dëmtuara rëndë, tregojnë se zbatimi i ligjit dhe fusha e rregulluar prej tij nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe nuk kanë funksionuar mirë. Megjithatë me ligj jepej e drejta e lidhjes së marrëveshjes për qiranë e tokës dhe e përfitimit të stimujve fiskalë, nuk parashikoheshin strukturat e kontrollit dhe nuk krijohej lidhje me kriteret dhe standardet e pritshme të zhvillimit.

Ligji parashikonte disa detyrime dhe përgjegjësi për zhvilluesit. Megjithatë ato edhe pse sollën një rritje të numrit të turistëve, nuk ndikuan aq sa pritej në kualitetin dhe impaktin e zhvillimit.

Projektligji i ri synon përcaktimin e parimeve dhe të rregullave, që veprojnë në fushën e turizmit, si dhe vendosjen e zhvillimin e standardeve të shërbimeve turistike dhe të shërbimeve të tjera, të lidhura me të. Shteti nxit zhvillimin e turizmit në kushtet e ekonomisë së tregut, bazuar në konkurrencën dhe nismën e lirë private.

Gjithashtu, projektligji synon rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, persona fizikë/juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike, si dhe përcaktimin e të drejtave dhe të detyrimeve të subjekteve pjesëmarrëse në veprimtari turistike, në përputhje me standardet e vendosura në këtë ligj, si dhe çështje të tjera, që lidhen me fushën e turizmit.

Ky projektligj kërkon ta shndërrojë Shqipërinë në një vend tërheqës dhe të sigurtë për investitorët e huaj, për diasporën shqiptare, si dhe për vetë biznesin e brendshëm. Po ashtu, nëpërmjet këtij ligji, vizitori, që është dhe konsumatori i shërbimeve të plota turistike shqiptare, gjen mbrojtjen dhe garancitë, që në legjislacionin në fuqi mungonin (si për shembull e drejta për t'u ankuar dhe për të marrë dëmshpërblim ndaj një shërbimi turistik të mun-

guar ose me të meta, për faj të akomoduesit apo operatorit turistik, strukturat shtetërore, pranuese dhe përpunuese, të ankimit, sikurse do të jetë zyra e asistencës për turistët, etj.). Një komunitet që merret me veprimtari turistike, i mbrojtur me ligj në Shqipëri, përbën garancinë themelore të investuesit të huaj në turizëm. Ky projektligj përcakton kriteret, mbi të cilat duhet të zbatohet politika e deklaruar “Shqipëria një euro”.

Projektligji është rezultat i një procesi të gjerë këshillimesh me të gjitha grupet e interesit, në workshopet e datave 5, 10 dhe 13 korrik 2006, përkatësisht në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër. Të gjitha problemet e dala gjatë zhvillimit të tyre kanë gjetur zgjidhje në këtë projekt. Nga biznesi turistik, në këtë kuadër, u paraqit edhe një variant paralel ligji, me këndvështrimin dhe perspektiven e interesave të tij të zhvillimit.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces ka luajtur Organizata Botërore e Turizmit, e cila financoi hartimin e projektit paraparak të këtij ligji dhe agjencia holandeze për zhvillim, SNV, si një organizëm, që bashkërendoi punën me OBT-në.

Nga diskutimet me pjesëmarrësit, duke patur parasysh problematikën e ligjit në fuqi, u arrit në përfundimin se ligji i ri:

- duhet ta bëjë Shqipërinë vend me një përcaktim të plotë turistik, me të gjitha llojet e ofertave të turizmit të rërës, detit dhe turizmit kulturor, arkeologjik, historik, të turizmit të bardhë e alpin, të atij të natyrës, të aventurës, etj.;
- i krijon mundësi turistit të gjejë mbrojtje dhe garanci ligjore;
- rregullon dhe standardizon veprimtarinë turistike;
- nxit shpërndarjen e përfitimeve nga veprimtaritë turistike, duke sjellë të ardhura dhe duke çelur vende pune;
- lehtëson procedurat për realizimin e investimeve nga komuniteti i biznesit në këtë fushë;
- siguron klientin;
- krijon mekanizma për trajnimin e burimeve njerëzore.

Ky projektligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, persona fizikë/juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike, si dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve pjesëmarrëse në veprimtari turistike, në përputhje me standardet, si dhe çështje të tjera, që lidhen me fushën e turizmit.

Projektligji synon të ndreqë një sërë të metash, të hasura gjatë zbatimit të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993, “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar, të tilla si:

1. Infrastruktura e dobët;
2. Turizëm i zhvilluar jo në të gjithë vendin;
3. Mungesa e mekanizmave të sigurisë turistike;
4. Ndërtime jo të rregulluara mirë dhe ndonjëherë të jashtëligjshme;
5. Zhvillim i paplanifikuar mirë në bregdet dhe në të ashtuquajturat “Fshatra turistike”;
6. Një sistem incentivash, nën skemën e “Personit të stimuluar”, që jepen jo aty ku ka nevojë më shumë për to.
7. Një kapacitet institucional shumë i kufizuar për të udhëhequr sektorin.

(vijon në faqen 10)

Projektligji “Për Turizmin”

(vijon nga faqja 9)

Nëpërmjet këtij projektligji vendi ynë synon të ketë një industri turistike të qëndrueshme, pasi projektligji përcakton dhe bazohet në disa kolona kryesore:

a) Turizmi zhvillohet bazuar në thesarin kulturor, arkeologjik e natyror, në traditat dhe zakonet tona, duke ruajtur dhe mbrojtur burimet natyrore dhe mjedisore.

b) Planifikimi, organizimi dhe zbatimi i planeve turistike të bashkive dhe komunave bëhet pjesë integrale e një plani strategjik veprimi, në nivel kombëtar.

c) Të gjitha palët e interesuara (komuniteti vendor, njësitet vendore, biznesi, OJF-të vendore, etj.) marrin pjesë aktivisht në proceset e planifikimit për zhvillimin e turizmit në nivel, vendor dhe kombëtar, në përputhje me politikatat dhe strategjitë e përcaktuara nga Komiteti i Lartë për Turizmin. Ky komitet krijohet si një organ ndërinstitucional vendimmarrës pranë Kryeministrit, përbërja dhe funksionimi i të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

ç) Garantohen asistencë financiare për biznesin turistik privat dhe, për këtë, krijohet një fond kombëtar për zhvillimin e turizmit, i cili menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, që do të jetë në varësi të ministrisë përgjegjëse për turizmin. Statusi i AKT-së do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

d) Krijohen struktura, të cilat mundësojnë këshillimin e sektorit privat të turizmit, si dhe krijohet komiteti i nëpunësve të turizmit të njësive të qeverisjes vendore, i cili vepron në nivele vendore, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, etj.

dh) Garanton transparencë, kritere dhe standarde të unifikuara për subjektet, që licencohen për ushtrimin e veprimtarive turistike, si dhe parashikon sanksione për subjektet, që veprojnë në kundërshtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore, që do të dalin në zbatim të tij.

e) Garanton informacion dhe asistencë për turistët, nëpërmjet nëpunësve të zyrave të asistencës për turistët, struktura në varësi të MTKRS-së, të cilat kanë detyra dhe përgjegjësi për mbikëqyrjen e vendosjen e gjobave ndaj subjekteve, që shkelin kërkesat e këtij ligji.

ë) Përcakton mekanizma të qarta ligjore, procedurale e administrative për vendosjen e sanksioneve, pagesën dhe ankimin, deri në ekzekutimin e tyre.

f) Garanton, nëpërmjet kurseve kualifikuese, ngritjen e cilësisë së shërbimeve turistike dhe dhënien e çertifikatave përkatëse personave, që ushtrojnë veprimtari turistike.

g) Parashikon një sërë aktesh nënligjore, që bëjnë të mundur zbatimin e këtij ligji, pas hyrjes në fuqi të tij, ndërsa në dispozitat kalimtare parashikohen mënyra e kushtet e trajtimit të subjekteve, që zhvillojnë apo duan të zhvillojnë veprimtari turistike, në përputhje me standardet, kriteret dhe parimet e vendosura në këtë ligj.

Projektligji synon decentralizimin dhe pjesëmarrjen publike në proceset e vendimmarrjes për turizmin në të gjitha nivelet. Ai promovon natyrën dhe menaxhimin e burimeve natyrore, lehtëson përfshirjen e biznesit privat dhe të komuniteteve vendore në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, sanksionon të drejtat e turistëve vendas dhe të huaj, mbron të drejtat e bizneseve të sektorit. Projektligji përcakton qartë rolin e organeve të ndryshme shtetërore në

qeverisjen, menaxhimin dhe planifikimin e burimeve turistike. Ai siguron transparencë, efikasitet në drejtimin e sektorit të turizmit dhe ndihmon sektorin privat të kësaj industrie, që të jetë një partner aktiv në zhvillimin e turizmit, në nivel kombëtar.

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve e i rregullave, që veprojnë në fushën e turizmit, si dhe vendosja e zhvillimi i standardeve të shërbimeve turistike dhe të shërbimeve të tjera, të lidhura me të. Shteti nxit zhvillimin e turizmit në kushtet e ekonomisë së tregut, në bazë të konkurrencës dhe nismës së lirë private.

Neni 2

Objekti

Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, persona fizikë/juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike, si dhe përcakton të drejtat e detyrimet e subjekteve pjesëmarrëse në këto veprimtari, në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe çështje të tjera, që lidhen me fushën e turizmit.

Neni 3

Subjektet dhe fusha e zbatimit

1. Personat juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, e zhvillojnë veprimtarinë turistike, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Personat, juridikë dhe fizikë, që zhvillojnë veprimtari turistike biznesi, në baza kontraktuale, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, në zbatim të tij, për turizmin. Për sa kohë që ato nuk bien në kundërshtim me ligjin e vendit, ku zhvillohen.

Neni 4

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtme nënkuptohen:

1. “Agjent terreni” - personi, që përgatit shërbime turistike për klientët e një operatori turistik ose të organizatorëve të tjerë, vendi i ushtrimit të biznesit të të cilëve është jashtë Republikës së Shqipërisë. Ky term vlen, gjithashtu, edhe për “operatorë turistike hyrës”.

2. “Agjent udhëtimi” - personi, që, zakonisht ose rregullisht, merr përsipër t’u sigurojë personave të tjerë, kundrejt një çmimi, një ose disa shërbime të veçanta, që mundësojnë një udhëtim turistik ose qëndrim të përkohshëm. Këto shërbime përfshijnë, por që nuk kufizohen në:

a) shitjen e paketave të udhëtimit në emër të operatorëve të udhëtimit (vendas ose ndërkombëtarë).

b) përgatitjen e dokumenteve të udhëtimit, në përputhje me rregulloren në fuqi.

c) përgatitjen për transportin dhe/ose akomodimin e udhëtarëve.

3. “Akomodira turistësh” - shërbimi që u ofron vizitorëve

(vijon në faqen 11)

Projektligji “Për Turizmin”

(vijon nga faqja 10)

akomodim fjetjeje, në mënyrë tregtare ose biznesi, i përshtatshëm për t'u regjistruar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. “Burime turistike” - komponentët mjedisorë, natyrorë dhe antropologë, që janë bërë të njohura dhe janë regjistruar si burime turistike për cilësinë dhe veçoritë e tyre e që janë kapitalizuar përmes turizmit.

5. “Fshat turistik” - një fshat ekzistues apo një strukturë e re, me përqendrim të burimeve turistike, i klasifikuar në përputhje me standardet e miratuara për zhvillimin e turizmit e që gëzon privilegje të caktuara, sipas dispozitave të këtij ligji.

6. “Vend turistik” - një vend me burime turistike natyrore, me një epërsi të veçantë, i cili ka kapacitet për të tërhequr turistë, vendas dhe të huaj, me një infrastrukturë të harmonizuar dhe mjedise moderne, që plotësojnë kërkesat e turistëve.

7. “Guidë turistike” - personi, i cili, kundrejt pagesës, shoqëron turistët, duke u përshkruar dhe/ose shpjeguar atyre arkeologjinë, historinë, natyrën, arritjet dhe kulturën e popullit të asaj treve.

8. “Hotel” - një ndërtesë, që ka jo më pak se 6 dhoma në dispozicion për akomodimin e përshtatshëm të udhëtarëve, ku ofrohet ushqim, pije dhe, nëse kërkohet, akomodim, çdo udhëtar, pa ndonjë kontratë të veçantë, që është i gatshëm të paguajë shumën e shpallur për shërbimet dhe mjediset. Mjediset duhet të përdoren për qëllime të ushtrimit të zanatit të hotelierit.

9. “Hotelier” - personi, që zotëron, është pronar i autorizuar ose qiramarrës i një hoteli.

10 “Hua” - dhënia e parave, sipas një programi asistence financiare, përgatitur nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas këtij ligji, me kusht kthimin e tyre, me ose pa interes.

11. “Grant” - një e ardhur në para, në formë dhurimi, e parashikuar në një program asistence financiare, i përgatitur sipas nenit 21, të këtij ligji, pa kusht kthimi.

12. “Operator turistik” - një person, që, zakonisht ose rregullisht, kundrejt një çmimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndërmjetës, organizon udhëtime ose paketa udhëtimesh për publikun, të cilat përfshijnë dy ose më shumë nga shërbimet e mëposhtme:

a) Udhëtime me shoqërues;

b) Akomodim;

c) Argëtim;

ç) Transport.

13. “Operator turistik hyrës” - agjent terreni.

14. “Operator turistik i jashtëm” - një operator turistik, që ofron shërbimet e përshkruara në përkufizimin “operator turistik”, por me destinacion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

15. “Kontratë” - marrëveshja, që lidhet ndërmjet klientit/konsumatorit të paketës turistike dhe shitësit të paketës apo shërbimit turistik.

16. “Organ publik” - çdo person juridik publik, sipas Kodit Civil, i përcaktuar i tillë në funksion të këtij ligji.

17. “Ofrues transporti për turistët” - një person që u ofron transport vizitorëve, me mjete motorike, lundruese, anije e varka, avion, helikopter ose me kafshë.

18. “Paketë turistike” - një paraorganizim i kombinimit të

jo më pak se dy nga shërbimet e përmendura në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 12, të këtij neni, si transporti dhe akomodimi, si dhe shërbime të tjera plotësuese, kur shitet ose ofrohet për shitje me çmim të përfshirë dhe kur ky shërbim mbulon një periudhë, më shumë se njëzet e katër orë.

19. “Pikë turistike” - një destinacion i krijuar për një kohë të gjatë, i hapur për publikun për zbavitje, argëtim, çlodhje, interes të veçantë; edukim, disa ose të gjitha nga këto, që tërheq vizitorë, ditorë ose turistë; ose, një ngjarje, që zhvillohet në një vend, i cili përdoret për një kohë të gjatë ose përkohësisht, për këtë qëllim, duke shfrytëzuar natyrën argëtuese dhe çlodhëse.

20. “Restorant” - një ndërtesë, ku i ofrohet ushqim dhe pije, për konsumim, brenda mjedisit, çdo udhëtar, që është i gatshëm të paguajë shumën e shpallur të ushqimeve dhe pijeve.

21. “Shërbime turistike” - shërbimet që u ofrohen turistëve nga sipërmarrjet turistike.

22. “Sipërmarrje turistike” - një person i angazhuar në veprimtarinë e agjencisë së udhëtimit, operatorit turistik, agjencisë në terren, transportit të turistëve, prodhimit ose shitjes me pakicë të suvenirëve a punimeve artizanale, pikat e tërheqjes së vizitorëve, sportet ujore ose në ndonjë biznes tjetër të licencuar, si sipërmarrje turistike nga ministri përgjegjës për turizmin.

23. “Turizëm” - veprimtaritë e personave, që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm, për jo më shumë se 1 vit radhazi për argëtim, punë dhe qëllime të tjera, që nuk lidhen me ushtrimin e ndonjë veprimtarie, që paguhet nga vendi i vizituar, dhe, gjithashtu, i referohet sektorit të ekonomisë kombëtare me funksione komplekse, që lidh një numër mallrash dhe shërbimesh, të cilat u ofrohen për konsum këtyre njerëzve.

24. “Turizëm i qëndrueshëm” - veprimtaria turistike, që përbush nevojat e turistëve ekzistues dhe të rajoneve pritëse, ndërsa mbron dhe rrit mundësitë për të ardhmen; veprimtaria, që çon në administrimin e të gjitha burimeve në mënyrë që nevojat ekonomike, shoqërore dhe estetike të përbushen, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, edhe integritetin kulturor, procesin thelbësor ekologjik, diversitetin biologjik dhe sistemet e përkrahjes jetësore.

25. “Turist” - një vizitor, i cili qëndron të paktën në një ndalesë, për një natë, në një hotel ose në akomodime të tjera turistësh, dhe, ose një konsumator të shërbimeve turistike.

26. “Turizëm vendas” - veprimtaritë turistike, të ndërmarrura nga shtetas shqiptarë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

27. “Turizëm i brendshëm” - veprimtaritë turistike, të ndërmarrura nga shtetas joshqiptarë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nga turizmi vendas.

28. “Turizëm i huaj” - veprimtaritë turistike, të ndërmarrura nga shtetas joshqiptarë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

29. “Turizëm kombëtar” - veprimtaritë turistike, të ndërmarrura nga shtetas shqiptarë, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

30. “Ekskursionist” - një vizitor, që udhëton për qëllime

(vijon në faqen 12)

Projektligji "Për Turizmin"

(vijon nga faqja 11)

turizmi, pa kaluar natën në vendin, që viziton.

31. "Veprimtari turistike" - veprimtaria, që zhvillohet në bazë të kërkesës dhe ofertës.

32. "Trashëgimia turistike" - burimet turistike natyrore dhe antropologjike, baza, materiale dhe teknike, infrastruktura e përgjithshme, infrastruktura e turizmit dhe mallrat për konsumim nga turistët.

33. "Burime kulturore" - veprimtaritë kulturore, që zhvillohen në një vend të caktuar.

34. "Turizëm kulturor" - veprimtaritë turistike, që kanë si qëllim kryesor vizitat në burimet turistike të një vendi, qyteti, fshati ose rajoni të caktuar.

35. "Udhëtar" - një person, që nuk është banor i një hotele, bujtine, hoteli familjar ose akomodimi tjetër turistësh, i cili kërkon të qëndrojë në hotel, bujtinë, hotel familjar, për t'u akomoduar për shërbime dhe lehtësi të këtij lloji ose për ushqime dhe pije, sipas mundësisë, dhe për të cilat ai është i gatshëm të paguajë. Nuk ka rëndësi çfarë mjeti transporti përdor, apo nëse ka përdorur apo jo një mjet të tillë.

36. "Vizitor" - çdo person, që udhëton në një vend, të ndryshëm nga rezidenca e vet e zakonshme, për më pak se 12 muaj, dhe që nuk ka si qëllim të ndërmarrë veprimtari, që paguhen në vendin e vizituar.

37. "Zonë e zhvillimit të turizmit" – zonë e cila ka burime turistike të mjaftueshme për zhvillimin e turizmit dhe që do të jetë subjekt i kufizimeve të planifikimit.

38. "Licencë" - certifikata, që lëshohet nga ministria përgjegjëse për turizmin, në përputhje me dispozitat e nenit 26, të këtij ligji.

39. "Ministri përgjegjës për turizmin" - autoriteti përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë shtetërore të turizmit.

40. "Ministria përgjegjëse për turizmin" - personi juridik publik, që mbështet, në aspektin teknik veprimtarinë shtetërore të ministrit përgjegjës për turizmin.

KREU II

PARIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË TURIZMIT

Neni 5

Parimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit

1. Turizmi dhe veprimtaritë e tjera, të lidhura me të, mbështeten në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me trashëgiminë kulturore kombëtare, traditat dhe zakonet e popullit shqiptar, si dhe me parimin e mbrojtjes e të përdorimit të njëjtë të burimeve turistike.

2. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit do të sigurohet nga respektimi i parimeve të turizmit të qëndrueshëm, nëpërmjet:

a) organizimit dhe zbatimit të planifikimit turistik, në nivel vendor, si pjesë përbërëse e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në nivel kombëtar;

b) përfshirjes së organeve të ndryshme publike, të sektorit privat, shoqatave, profesionale dhe tregtare, e OJF-ve përkatëse, si dhe të popullsisë në procesin e planifikimit;

c) planifikimit dhe administrimit turistik, duke respektuar mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore;

ç) shpërndarjes së barabartë të avantazheve dhe të kostove, ndërmjet promovuesve të turizmit, bashkive dhe komunave (njësive të qeverisjes vendore) dhe popullsisë

në vendet pritese:

d) informimit arsimimit, motivimit dhe përfshirjes së popullsisë vendase në procesin e krijimit të lehtësive të turizmit;

dh) vlerësimit paraprak të projekteve me përfitim të lehtësive, sipas programeve të financimit dhe të ndikimeve të mundshme të tyre pas zbatimit;

e) përfshirjes së popullsisë vendase në hartimin e programeve të përbashkëta për zhvillimin e turizmit.

3. Institucionet përgjegjëse për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit zbatojnë parimet e këtij ligji, duke:

a) siguruar dhe garantuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve turistike, mbrojtjen e ruajtjen e mjedisit, masa mbrojtëse, në përputhje me strategjitë kombëtare dhe programet vjetore të turizmit dhe mjedisit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

b) promovuar interesin publik në zonat e zhvillimit të turizmit.

c) kontribuar në zhvillimin e industrisë së turizmit, nëpërmjet investimeve të drejtpërdrejta, në përgjithësi dhe në infrastrukturën turistike, në veçanti.

ç) krijuar kushte të mjaftueshme për zhvillimin e infrastrukturës së turizmit, në nivel vendor.

d) garantuar sigurinë, mbrojtjen e të drejtave, të intereseve dhe pronën e turistëve.

dh) bashkëpunuar me institucione homologe dhe organizatat ndërkombëtare, në fushën e turizmit, nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare.

e) siguruar për turistët lehtësitë e nevojshme në pikat e kalimit kufitar.

ë) monitoruar, me mekanizma ligjore, zbatimin e rregullave, që veprojnë në fushën e turizmit.

f) mbrojtur, zhvilluar, përdorur dhe administruar, në mënyrë efikase dhe të njëjtë, burimet turistike, në të gjithë vendin, si dhe duke marrë masa të njëkohshme dhe të bashkërenduara, për mbrojtjen dhe përmirësimin e burimeve turistike për zhvillim të qëndrueshëm.

KREU III

STRUKTURAT INSTITUCIONALE PËR TURIZMIN

Neni 6

Ministria përgjegjëse për turizmin

Ministria përgjegjëse për turizmin ka këto detyra:

a) Zbaton parimet bazë të zhvillimit të turizmit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi, në këshillim dhe bashkëpunim me komunitetin e biznesit të turizmit;

b) Paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave linjën e veprimtari dhe strategjinë kombëtare të turizmit;

c) Zbaton dhe përkrah/mbështet linjën e veprimtari dhe strategjinë kombëtare, si dhe mbikëqyr realizimin e saj;

ç) Mbështet, mbron, zhvillon dhe promovon burimet turistike, kulturën dhe trashëgiminë, materiale e jomateriale, të popullit shqiptar, në përputhje me linjën e veprimtari dhe në bashkëpunim me institucionet qëndrore, vendore, sektorin privat të turizmit dhe shoqërinë civile;

d) Rregullon veprimtarinë e bizneseve turistike në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 7

Komiteti ndërministror për turizmin

1. Komiteti ndërministror për turizmin, në vazhdim
(vijon në faqen 13)

Projektligji "Për Turizmin"

(vijon nga faqja 12)

"KNT", është një organ këshillimor i Këshillit të Ministrave, sipas nenit 11, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".

2. Komiteti ndërmintor për turizmin, përveç detyrave të tjera, që mund t'i caktohen në aktin e krijimit, shqyrton:

- a) strategjitë e ardhshme të zhvillimit të turizmit në Republikën e Shqipërisë dhe planet e veprimit në nivel kombëtar dhe në zonat pilot për zhvillimin e turizmit;
- b) orienton politikën për zhvillimin e një industrie të qëndrueshme të turizmit në Republikën e Shqipërisë dhe fuqizimin e vetëorganizimit e të kontrollit të sektorit privat në turizëm.

Neni 8

Komiteti këshillimor i sektorit privat të turizmit

1. Komiteti këshillimor i sektorit privat të turizmit, në vazhdim KKSPT, krijohet si një organ këshillimor për këtë sektor, që funksionon në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin. Veprimtaria e KKSPT-së zhvillohet në përputhje me rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

2. KKSPT-ja kryesohet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe në përbërje ka përfaqësues nga:

- a) shoqata kombëtare profesionale e operatorëve të udhëtimit;
- b) shoqata kombëtare profesionale e agjentëve të udhëtimit;
- c) shoqata e hoteleve dhe e njësive akomoduese;
- ç) sipërmarrjet turistike si: guida turistike, pronarë bar-restorantesh apo shitës suveniresh;
- d) Dhoma Shqiptare e Tregtisë dhe Industrisë.

Kur anëtarët e KKSPT-së e gjykojnë të arsyeshme, mund të përfshijnë në komitet edhe përfaqësues të sektorit privat apo të institucioneve donatorëve ndërkombëtarë, që veprojnë në fushën e turizmit.

3. KKSPT -ja ka këto detyra:

- a) Trajton dhe shqyrton çështje, që kanë lidhje me veprimtarinë turistike të sektorit privat ose që mund të dalin gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.
- b) Siguron bashkëpunim, ndërmjet sektorit privat dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin, për çështje, që mund të lindin gjatë zhvillimit të turizmit, zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Turizmit dhe planit të veprimit;
- c) Jep informacione për sektorin privat të turizmit dhe i sugjeron ministrisë përkatëse marrjen e masave për çështje që kanë të bëjnë me turizmin.

Neni 9

Njësitë e qeverisjes vendore dhe detyrat e nëpunësve të këtyre njësive për turizmin

1. Njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi, emërojnë në strukturën organike të njësive vendore një nëpunës përgjegjës për turizmin, kur në territorin e administruar prej tyre ndodhen zona të zhvillimit të turizmit, apo zona me burime turistike sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Nëpunësi përgjegjës për turizmin, në zbatim të këtij ligji, ka detyrë:

- a) të krijojë inventarin e burimeve kryesore turistike të njësive të qeverisjes vendore dhe inventarin e bizneseve turistike, në nivel vendor.

- b) të përcjellë, në mënyrë periodike, dy herë në vit, inventarët e mësipërm pranë ministrit përgjegjës për turizmin, për krijimin e bazës së të dhënave në nivel kombëtar.

- c) të japë asistencë teknike për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve turistike, në përputhje dhe në zbatim të këtij ligji.

- ç) të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të tjera ligjore nga subjektet private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit, dhe të propozojë masat përkatëse për institucionet.

KREU IV

KUADRË I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Neni 10

Mbështetja për zhvillimin e turizmit

1. Organet shtetërore, në bashkëpunim dhe në kujdesin e ministrit e të ministrisë përgjegjëse për turizmin, ndihmojnë zhvillimin e turizmit, duke:

- a) hartuar planet e zhvillimit të turizmit, për çdo bashki dhe komunë;
- b) dhënë informacione turistike dhe duke organizuar veprimtari arsimuese dhe promovimi;
- c) marrë masa për zhvillimin e infrastrukturës dhe krijimin e lehtësive në zonat e zhvillimit turistike, fshatrat turistike, zonat turistike, vendet turistike dhe pikat turistike;
- ç) mbështetur investimet në turizëm në zonat e thella, malore dhe me popullsi të rrallë.

2. Zhvillimi i turizmit do të realizohet nëpërmjet zbatimit të lehtësive fiskale për bizneset turistike, për individët dhe subjektet juridike në zonat e zhvillimit turistike, fshatrat turistike, vendet dhe pikat turistike, që veprojnë në sipërmarrjet turistike.

Neni 11

Klasifikimi i burimeve turistike

1. Burimet turistike në Republikën e Shqipërisë klasifikohen në:

- a) burime natyrore turistike, ku përfshihen pejsazhet natyrore, zonat e mbrojtura, veçoritë gjeografike e biologjike, kushtet klimatike, detare, hidrografike dhe objektet e tjera fizike, natyrore apo gjeomumentale, që janë tërheqëse për turistët.

- b) burime njerëzore turistike, që ndahen në:

- i. burime materiale njerëzore turistike, ku përfshihen ndërtesat historike, reliket e ndërtimet e tjera, si dhe artifikatet;
- ii. burime jomateriale njerëzore turistike, që nënkupton veprimtaritë e ndryshme kulturore.

2. Burimet turistike përfshijnë si ato që shfrytëzohen në mënyrë tregtare edhe ato që nuk përdoren në këtë mënyrë.

Neni 12

Regjistri kombëtar i burimeve turistike

1. Ministria përgjegjëse për turizmin harton dhe administron regjistrin kombëtar të burimeve turistike.

2. Ministria përgjegjëse për turizmin identifikon, inventarizon dhe promovon burimet turistike nëpërmjet sigurimit të të dhënave të lidhura me to, që kanë organet publike të qeverisjes, qëndrore apo vendore, të caktuara për administrimin e burimeve turistike (në vazhdim "organet administruese të burimeve turistike").

(vijon në faqen 14)

Projektligji "Për Turizmin"

(vijon nga faqja 13)

3. Përditëson çdo vit të dhënat në regjistrin kombëtar të burimeve turistike.

4. Pronarët ose organet administruese të burimeve turistike regjistrojnë burimet turistike në regjistrin kombëtar të burimeve turistike.

Neni 13

Përgjegjësia për administrimin e burimeve turistike

1. Personat, fizikë dhe juridikë, organet publike qëndrore/vendore apo personat/privatë, që zotërojnë a administrojnë burime turistike, janë përgjegjës për administrimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të lidhura me të.

2. Prefektët janë përgjegjës për bashkërendimin e punës së bashkive, komunave dhe organeve publike, të angazhuara në zhvillimin e turizmit brenda territorit të tyre për mbrojtjen, rritjen dhe përdorimin e burimeve turistike për maksimizimin e potencialit ekonomik të tyre, në përputhje me nenin 5, të këtij ligji.

KREU V

ZONAT, VENDET DHE PIKAT TURISTIKE

Neni 14

Përcaktimi i zonave, vendeve dhe i pikave turistike

Përcaktimi i zonave, vendeve dhe i pikave turistike bëhet në bazë të masterplanit kombëtar të zhvillimit të turizmit, të regjistrit të burimeve turistike dhe planifikimit të zhvillimit ekonomik-social të tyre.

Neni 15

Shpallja e zonave, vendeve dhe pikave turistike

Shpallja e zonave, vendeve dhe pikave turistike bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 16

Procedura për përcaktimin e një fshati turistik

1. Standardet, kriteret dhe procedurat për përcaktimin dhe njohjen e një fshati turistik parashikohen në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Propozimi për njohjen e një fshati turistik paraqitet nga organet e qeverisjes vendore dhe/ose nga persona juridikë, publikë ose privatë, të ministri përgjegjës për turizmin dhe përmban këto dokumente:

a) Raportin për përmbushjen e standardeve dhe të kriterëve të përcaktuara në rregullore, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, dhe standardet e kriteret mjedisore të ndikimit në mjedis, sipas legjislacionit në fuqi;

b) Një kopje të planit të hollësishëm të zhvillimit të turizmit;

c) Planin, ku identifikohen burimet njerëzore, infrastruktura dhe shërbimet teknike, në dispozicion, dhe projektet për zhvillimin e tyre, në të ardhmen.

ç) Planin e terrenit të rezervuar, për zgjerim dhe krijim të fshatit turistik.

3. Procedura për njohjen e një fshati turistik nuk duhet të kalojë 60 ditë nga depozitimi i kërkesës dhe i dosjes përkatëse në ministrinë përgjegjëse për turizmin.

Neni 17

Lehtësitë e fshatit turistik

Përfitimi i lehtësive dhe i asistencës financiare për një fshat turistik bëhet në përputhje me përcaktimet e procedurave të përmendura në nenin 24, të këtij

KREU VI

PLANIFIKIMII ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Neni 18

Planifikimi i zhvillimit të turizmit

1. Planifikimi i zhvillimit të turizmit bëhet në bazë të:

a) regjistrit kombëtar të burimeve turistike.

b) planeve, në nivel kombëtar, bashkiak dhe komune, për zhvillimin e turizmit.

c) orientimit ndaj zonave të zhvillimit turistik dhe aty ku zhvillimi turistik është në gjendje të nxisë ristrukturimin social-ekonomik.

2. Planet për zhvillimin e turizmit shqyrtohen dhe rishihen periodikisht, për të siguruar përputhshmëri me situatën e zhvillimit social-ekonomik, në nivel kombëtar, bashkiak dhe komune.

Neni 19

Përmbajtja e planeve të zhvillimit të turizmit

1. Planet e zhvillimit të turizmit përgatiten në bazë të parimeve të zhvillimit të turizmit dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Këto plane përmbajnë:

a) Parashikimet për zhvillimin e turizmit dhe përcaktimin e zonave të veçanta për këtë qëllim;

b) Vlerësimin e kapitalit të investimit të investitorëve të ndryshëm, në përputhje me planet në nivel kombëtar, bashkiak dhe komune, të zhvillimit për një periudhë prej 5 vjetësh, 10 vjetësh ose më gjatë.

c) Parashikimet e planit të punimeve në infrastrukturën e zonës, të vendeve dhe pikave turistike, në përputhje me potencialin turistik dhe planet e zhvillimit social-ekonomik kombëtar, rajonal dhe vendor.

ç) Parashikimet e veprimtarive të promocionit dhe marketingut;

d) Parashikimet e veprimtarive arsimuese dhe të vazhdimësisë së zhvillimit profesional.

Neni 20

Hartimi i planeve hapësinore për zhvillimin e turizmit

1. Hartimi i planeve hapësinore për zhvillimin e turizmit duhet të mbështetet në strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe të sigurojë zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm turistik.

2. Kontrolli i zhvillimit hapësinor, që kryhet nga institucionet përkatëse, duhet të sigurojë përputhjen me objektivat strategjike të zhvillimit të turizmit.

KREU VII

AGJENCIA KOMBËTARE E TURIZMIT

Neni 21

Agjencia Kombëtare e Turizmit

1. Agjencia Kombëtare e Turizmit, në vazhdim AKT, krijohet si ent publik buxhetor, me statusin e personit juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin.

2. AKT-ja ka si objekt dhe qëllim:

a) të përkrahë/ndihmojë dhe të mbështesë sigurimin e financimit për personat, që kryejnë ose kanë qëllim të kryejnë sipërmarrje turistike;

b) të hartojë programet e asistencës financiare për projektet turistike, të cilat nëpërmjet ministrit përgjegjës për turizmin, ia paraqet komisionit të ndihmës shtetërore, në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore";

c) të menaxhojë fondin kombëtar të zhvillimit të turizmit,

(vijon në faqen 15)

Projektligji "Për Turizmin"

(vijon nga faqja 14)

në përputhje me programin e miratuar të asistencës financiare;

ç) të inspektojë dhe garantojë zbatimin e kushteve, në bazë të të cilave u është dhënë asistencë financiare personave, që kryejnë sipërmarrje turistike;

d) të kontrollojë zbatimin dhe plotësimin e kriterëve për marrëveshjet ekzistuese të qirasë dhe të zhvillimit, të lidhura me subjektet;

dh) të sigurojë ose të ndihmojë në sigurimin e shërbimeve e të lehtësive për biznesin privat të turizmit, nëpërmjet tarifave të miratuara për këto shërbime;

e) të administrojë të ardhurat, që realizohen nga shërbimet e ofruara nga biznesi turistik dhe që përfitohen nga grantet/donacionet a burime të tjera financimi, të ligjshme;

ë) të kryejë funksionet, që kanë lidhje me promocionin dhe marketingun në fushën e turizmit, dhe funksione të tjera, të përcaktuara në këtë ligj.

3. Statuti i AKT-së, organizimi, mënyra e funksionimit dhe kompetencat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Drejtori i AKT-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga ministri përgjegjës për turizmin, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Neni 22

Struktura dhe organika e AKT-së

Struktura dhe organika e AKT-së përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 23

Fondi i zhvillimit të turizmit

Krijohet fondi i zhvillimit të turizmit, si pjesë e programit të zhvillimit të turizmit, i cili administrohet, për sigurimin dhe përmirësimin e zhvillimit të sektorit të turizmit, duke promovuar mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave, të vendeve dhe pikave turistike, vlerat e trashëgimisë kulturore dhe mbështetjen e profesionalizmit në sektorin e turizmit.

Neni 24

Programet e asistencës financiare për sipërmarrjet dhe projektet turistike

1. Ministria, nëpërmjet AKT-se, përgatit programe për sigurimin e asistencës financiare, për realizimin e projekteve të tilla, siç mund të përcaktohen në programe.

2. Këto programe duhet të jenë në përputhje me objektivat e këtij ligji dhe të sigurojnë a përmirësojnë sektorin e turizmit, të mbrojnë, ruajnë dhe promovojnë vendet turistike dhe vlerat e trashëgimisë kulturore, të mbështesin, përkrahin ose mundësojnë zhvillimin e veprimtarive kulturore, si dhe të mbështesin profesionalizmin në sektorin e turizmit.

3. Asistenca financiare për këto programe mund të jepet në formë granti, huaje ose përjashtimi nga taksat apo si një kombinim i tyre.

4. Kushtet dhe kriteret për përfitimin e asistencës financiare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe dispozitat, ligjore e nënligjore, në fuqi.

Neni 25

Organizimi i kontrollit për mënyrën e përfitimit dhe të

përdorimit të granteve, huave dhe përfitimeve të tjera financiare

Çdo person a strukturë, e autorizuar nga ministri për zhvillimin e turizmit, ka të drejtë, në çdo kohë, të inspektojë subjektin, që zhvillon veprimtari turistike, i cili ka përfituar nga grantet, huatë a taksat e përmendura në pikën 2, të nenit 23, të këtij ligji, për të parë nëse janë përfituar në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

Nëse subjekti, që ka përfituar asistencë financiare, nuk ka zbatuar kushtet e përcaktuara për marrjen e saj, ministri përgjegjës për turizmin ka kompetencë të vendosë, përveç gjobave të përcaktuara në nenin 49, të këtij ligji, edhe ndërprerjen e asistencës financiare, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

KREU VIII

STANDARDET DHE LICENCIMI

Neni 26

Standardet bazë të licencimit

1. Standardet, kriteret, rregullat e licencimit, procedurat për aplikim, ripërtëritje, transferim dhe heqje liçencë në fushën e turizmit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

2. Liçencimi për ushtrimin e veprimtarisë së turizmit bëhet nga ministri përgjegjës për turizmin.

Neni 27

Komisioni i standardeve të turizmit

Komisioni i standardeve të turizmit është një strukturë, që shqyrton kërkesat për marrjen e certifikatave, si dhe kërkesat për marrje, ripërtëritje, transferim dhe/apo heqje licence dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për turizmin, në kuptim të nenit 26, të këtij ligji.

Organizimi i këtij komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të tij miratohen me urdhër të veçante të ministrit përgjegjës për turizmin.

Rregullorja e funksionimit të këtij komisioni miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 28

Kategorizimi

KST-ja, pasi shqyrton kërkesat e personit, fizik e juridik, vendas e të huaj, i pajis ata me:

a) certifikatë për hotele dhe njësi akomodimi, për drejtimin e biznesit në ndërtesat e përcaktuara në të;

b) liçencë për guidë turistike.

Neni 29

Konflikti i interesave

Në asnjë rast anëtarët e KST-së nuk duhet të kenë konflikt interesash me subjektet, që kërkojnë të licencohen. Në të kundërt, veprohet në përputhje me ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave", dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi.

KREU IX

NJËSITË AKOMODUESE

Neni 30

Kriteret e ndërtimit të njësisve akomoduese dhe të restoranteve turistike

Ministri përgjegjës për turizmin miraton rregulloren përkatëse për kërkesat për projektimin dhe ndërtimin e njësisve akomoduese e të restoranteve turistike, e cila është e

(vijon në faqen 16)